Rhonda Byrne

F O R C A

(përmbledhje)



zgjodhi dhe përktheu

Ridvan Bunjaku

|:(|:)

Prishtinë, qershor 2013

Përmbajtja

ÇKA ËSHTË FORCA (FUQIA)? 3
FORCA E NDJENJAVE 4
FREKUENCAT E NDJENJAVE 5
FORCA DHE KRIJIMI 6
NDJENJA ËSHTË KRIJIM 7
JETA TË VJEN PAS 8
ÇELËSAT PËR TE FORCA 9
Çelësi i dashurisë 9
Çelësi i mirënjohjes 10
Çelësi i lojës 11
FORCA DHE PARATË 12
FORCA DHE MARRËDHËNIET 13
FORCA DHE SHËNDETI 14
FORCA DHE TI 15
FORCA DHE JETA 16
PUBLIKIME TJERA 17
Të lehta 18
Të mesme 19
Të avansuara 20

ÇKA ËSHTË FORCA (FUQIA)?

- Dashuria nuk është e dobët, e mekur, apo e butë. Dashuria është forca pozitive e jetës! Dashuria është shkaku i gjithçkaje pozitive dhe të mirë.
- Gjithçka që dëshiron të jesh, ta bësh, apo ta kesh vjen nga dashuria.
- Forca pozitive e dashurisë mund të krijojë gjithçka të mirë, t'i rrisë gjërat e mira, dhe ta ndryshojë gjithçka negative në jetën tënde.
- Çdo ditë, në secilin moment, ti e bën zgjedhjen se a do të duash, dhe a do ta shfrytëzosh forcën pozitive - apo jo.
- Ligji i tërheqjes është ligji i dashurisë, dhe është ligji që po operon në jetën tënde.
- Çkado që jep në jetë është ajo që të kthehet në jetë. Jip pozitivitet, të kthehet pozitivitet; jip negativitet, të kthehet negativitet.
- Jeta nuk të ndodh; ty të vjen gjithçka në jetën tënde bazuar në çka ke dhënë.
- Qofshin mendimet dhe ndjenjat e tua të mira apo të këqija, ato kthehen në mënyrë po aq automatike dhe precize sikur një jehonë.
- Njerëzit që kanë jetë të mëdha mendojnë dhe flasin për atë se çka duan më shumë se për atë se çka nuk duan.
- Fol për risitë e mira të ditës. Fol për atë se çka do. Dhe sille atë që e do te ti.
- Ti ke aftësi të pakufizuar për të menduar dhe folur për atë se çka do, dhe prandaj ke aftësi të pakufizuar të sjellësh gjithçka të mirë në jetë te ti!
- Duaj, sepse kur do je duke e përdorur forcën më të madhe në univers.

FORCA E NDJENJAVE

- Si ndihesh në secilin moment është më e rëndësishme se sa gjithçka tjetër, sepse mënyra si ndihesh tash po e krijon jetën tënde.
- Ndjenjat e tua janë forca e mendimeve dhe e fjalëve tua. Ajo që ka rëndësi është çka ndjen!
- Të gjitha ndjenjat e mira vijnë nga dashuria! Të gjitha ndjenjat negative vijnë nga mungesa e dashurisë.
- Secila ndjenjë e mirë të unifikon me forcën e dashurisë, sepse dashuria është burimi i të gjitha ndjenjave të mira.
- Zmadhoji ndjenjat e tua të mira duke menduar për të gjitha gjërat që i do. Numëroji gjërat që i do nonstop njërën pas tjetrës. Vazhdo të listosh gjithçka që do derisa të ndihesh mahnitshëm.
- Si ndihesh për secilën temë në jetën tënde është reflektim i saktë i asaj çfarë ke qenë duke dhënë në secilën temë.
- Jeta nuk është duke të ndodhur - jeta po të përgjigjet! Secila temë në jetën tënde është vendimi yt dhe ti e merr vendimin për gjithçka në jetë sipas asaj se çka jep.
- Ka nivele të pafund të ndjenjave të mira që mund t'i ndjesh, që domethënë se nuk ka fund për lartësitë e jetës që mund t'i pranosh.
- Të gjitha gjërat që i do të dëshirojnë! Paratë të dëshirojnë. Shëndeti të dëshiron. Lumturia të dëshiron.
- Mos u përpiq t'i ndryshosh me zor rrethanat e jetës tënde. Jip dashuri përmes ndjenjave tua të mira dhe ajo që e dëshiron do të shfaqet!
- Së pari pritet t'i japësh ndjenjat e mira. Së pari pritet të jesh person i lumtur, dhe të japësh lumturi, për të pranuar gjëra të lumtura! Çkado që dëshiron ta pranosh në jetë, së pari duhet ta japësh!

FREKUENCAT E NDJENJAVE

- Gjithçka në univers është magnetike dhe gjithçka ka frekuencë magnetike, përfshirë edhe mendimet dhe ndjenjat e tua.
- Çkado që ndjen, qoftë mirë apo keq, e përcakton frekuencën tënde, dhe ti tërheq njerëz, ngjarje, dhe rrethana që janë në frekuencën e njëjtë.
- Ndryshoje frekuencën tënde në çfarëdo kohe duke e ndryshuar si ndihesh, dhe gjithçka përreth teje do të ndryshojë sepse je në frekuencë të re.
- Nëse ka ndodhur diçka negative në jetën tënde, ti mund ta ndryshosh. Kurrë nuk është tepër vonë, sepse gjithmonë mund ta ndryshosh mënyrën se si ndihesh.
- Shumë njerëz i lënë ndjenjat e veta në pilot automatik; ndjenjat e veta janë reaksione ndaj asaj që iu ndodh atyre. Mirëpo, ata nuk e kuptojnë se janë ndjenjat e veta që janë shkaku i asaj që iu ndodh atyre.
- Për të ndryshuar çkadoqoftë - qofshin rrethanat e parave, të shëndetit, të marrëdhënieve apo çfarëdo subjekti - duhet ta ndryshosh mënyrën se si ndihesh!
- Fajësimi, kritikimi, gjetja e gabimit, dhe ankimi janë të gjitha forma të negativitetit, dhe të gjitha kthejnë asgjë pos konflikt.
- Gjuaji jashtë fjalorit tënd fjalët si e tmerrshme, e frikshme, e neveritshme, dhe katastrofë. Përdor më shumë fjalë si fantastike, mahnitëse, përrallore, brilante, e shkëlqyeshme, dhe e mrekullueshme.
- Edhe nëse jep vetëm 51 për qind mendime të mira dhe ndjenja të mira, i ke pozicionuar mirë peshoret e jetës tënde!
- Secila ditë është shans për jetë të re. Në secilën ditë ti rri në pikën e mesit të peshores së jetës tënde. Dhe në cilëndo ditë ti mund ta ndryshosh të ardhmen - përmes mënyrës se si ndihesh.

FORCA DHE KRIJIMI

- Për ta shfrytëzuar forcën e dashurisë në jetën tënde për të sjellë diçka që e dëshiron apo për të ndryshuar diçka që nuk e dëshiron, Procesi i Krijimit është gjithmonë i njëjtë: Imagjinoje. Ndjeje. Pranoje.
- Imagjinata jote të lidh me atë që e dëshiron. Dëshira jote dhe ndjenjat e tua të dashurisë e krijojnë magnetizmin, forcën magnetike, duke e tërhequr dëshirën tënde te ti!
- Imagjinoje veten duke qenë me dëshirën tënde. Në të njëjtën kohë, ndjeje dashurinë për atë që je duke e imagjinuar.
- Dëshiroje atë që e do me tërë zemrën tënde sepse dëshira është ndjenjë e dashurisë, dhe duhet të japësh dashuri për ta pranuar atë që e do!
- Kur imagjinon çkadoqoftë pozitive që e dëshiron dhe e do, je duke e shfrytëzuar forcën e dashurisë. Shtyje imagjinatën tënde në kufijtë e saj, dhe imagjinoje më të mirën dhe më të lartën që mundesh për çkadoqoftë ajo që e dëshiron ti.
- Çfarëdo qoftë dëshire që mund ta imagjinosh tashmë ekziston! Nuk ka rëndësi se çka është ajo: nëse ti mund ta imagjinosh, ajo ekziston në krijim.
- Në biseda dhe në mendimet tua thuaj, "Imagjino sikur…" ("Paramendo sikur…") dhe pastaj plotësoje fjalinë me atë që e dëshiron!
- Përdor objekte ndihmëse. Rrethoje veten me artikuj të veshjes, piktura, fotografi, dhe objekte relevante, ashtu që të mund ta imagjinosh dhe t'i ndjesh ndjenjat e të pasurit të asaj që e dëshiron.
- Edhe shqisat e tua janë ndihmesa. Përdori të gjitha shqisat e tua për të të ndihmuar që ta kesh atë që e dëshiron. Ndjeje, shijoje, nuhate, shihe, dhe dëgjoje!
- Kur e ke kryer pjesën tënde në Procesin e Krijimit, ti ke lëvizur në botë të re që e përmban pikërisht gjënë që e dëshiron edhe pse ti nuk mund ta shohësh ende. Dije se do ta pranosh!

NDJENJA ËSHTË KRIJIM

- Secili person është i rrethuar nga një fushë magnetike. Kudo që shkon, fusha magnetike shkon me ty.
- Ti tërheq gjithçka përmes magnetizmit të fushës tënde. Ndjenjat e tua e përcaktojnë se a është fusha jote pozitive apo negative në çdo kohë.
- Secilën herë që jep dashuri, përmes ndjenjave, fjalëve, apo veprimeve tua, ti shton më shumë dashuri në fushën përreth teje.
- Sa më shumë dashuri në fushën tënde, aq më shumë forcë ke për t'i tërhequr gjërat që i do.
- Imagjinoje atë që e dëshiron si të madhësisë së një pike! Për forcën e dashurisë, ajo që e dëshiron ti është më e vogël se një pikë!
- Nuk ke nevojë ta kthesh negativen në pozitive. Thjesht jip dashuri për atë që e dëshiron, sepse krijimi i asaj që e dëshiron e zëvendëson negativitetin!
- Kaloji shtatë minuta secilën ditë duke e imagjinuar dhe ndjerë se e ke atë që e dëshiron. Bëje këtë derisa e di se dëshira jote të përket ty, ashtu siç e di se emri yt të përket ty.
- Është vetëm një forcë në jetë dhe ajo forcë është dashuria. Ti ose ndihesh mirë sepse je plot dashuri, ose ndihesh keq sepse je bosh nga dashuria - por të gjitha ndjenjat e tua janë shkallë të dashurisë.
- Mendo për dashurinë sikur të ishte ujë në një gotë, dhe gota është trupi yt. Kur një gotë ka vetëm pak ujë në të, është bosh nga uji. Nuk mund ta ndryshosh nivelin e ujit në gotë duke bërë luftë në boshllëk dhe duke provuar ta shkulësh boshllëkun. Boshllëku shkon duke e mbushur gotën me ujë. Kur ke ndjenja të këqija, ti je bosh nga dashuria, dhe prandaj kur vendos dashuri në veten, ndjenjat e këqija kanë shkuar.
- Për t'u lehtësuar në lidhje me ndjenjat e këqija, imagjinoji ndjenjat e këqija si kuaj të egër në të cilët ti hip. Nëse ke hipur në ta mundesh edhe të zbresësh nga ta! Mund të zgjedhësh të zbresësh nga ai kalë po aq shpejt sa ke kërcyer në të.
- Ndryshoje atë që e jep, dhe gjithmonë, pa përjashtim, do ta ndryshosh atë që e pranon, sepse ky është ligji i tërheqjes. Ky është ligji i dashurisë.

JETA TË VJEN PAS

- Jeta të paraqet gjithçka ashtu që ti të zgjedhësh çka do!
- Nëse dikush ka diçka që e do ti, ji po aq i-e ngazëllyer sikur ta kishe. Nëse ndjen dashuri për të, ti po e sjell të njëjtën gjë te ti.
- Kur i sheh gjërat që i dëshiron, ti je në frekuencë të njëjtë sikur ato gjëra!
- Katalogu i jetës përmban gjëra që ti nuk i do, pra mos i zgjedh ato duke dhënë ndjenja të këqija.
- Kthejua shpinën gjërave që nuk i do dhe mos iu jep asnjë ndjenjë. Në vend të kësaj thuaj 'po' kur sheh diçka që e do.
- Ligji i tërheqjes po i përgjigjet ndjenjave të tua! Ka rëndësi vetëm ajo që ti e jep. Ligji i tërheqjes - është ligji i vetes tënde.
- Jip gjykim dhe kritikë dhe ia jep vetes. Jepi dashuri dhe vlerësim një personi tjetër apo cilësdo gjëje, dhe ia jep ato vetes.
- Kur njerëzit shohin mungesë të cilësdo gjëje, ajo është thjesht mungesë e dashurisë.
- Ti je mjaft i-e mirë tash. Nëse ke bërë diçka që nuk ishte e drejtë, të kuptuarit dhe pranimi yt i saj është falje për ligjin e tërheqjes.
- Janë besimet e tua, të vërteta apo të pavërteta, ato që e formojnë botën tënde.
- Imagjinata jote është më reale se sa bota që e sheh, sepse bota që e sheh vjen nga ajo që e imagjinon dhe beson! Ajo që e beson dhe e ndjen si të vërtetë është ajo që do të jetë jeta jote.
- Çfarëdo rrëfimi (historie) që e tregon, qoftë i mirë apo i keq, do të jetë rrëfimi i jetës tënde. Pra fillo ta tregosh rrëfimin e jetës tënde të mahnitshme, dhe ligji i tërheqjes duhet të kujdeset që gjithsesi ta pranosh atë.

ÇELËSAT PËR TE FORCA

ÇELËSI I DASHURISË

- Për ta përdorur dashurinë si forcën vendimtare në jetën tënde, duhet të dashurosh siç nuk ke dashuruar kurrë më herët. Bjer në dashuri me jetën!
- Shih vetëm dashuri, dëgjo vetëm dashuri, fol vetëm dashuri, dhe ndjeje dashurinë me tërë zemrën tënde.
- Nuk ka kufi, nuk ka lartësi maksimale, për sasinë e dashurisë që mund ta ndjesh, dhe ajo është krejt brenda teje! Ti je i-e bërë nga dashuria.
- Tregoji ligjit të tërheqjes se çka do çdo ditë duke i dalluar gjërat që i do dhe duke i ndjerë ato.
- Për ta ndryshuar mënyrën se si ndjehesh, apo për t'i ngritur ndjenjat e mira më lart, bëje një listë mendore të gjithçkaje që e do dhe admiron!
- Puna jote është të duash sa më shumë që mundesh secilën ditë.
- Bëj përpjekje të vetëdijshme të vëresh përreth teje gjëra që i do, sa më shumë që mundesh secilën ditë.

ÇELËSI I MIRËNJOHJES

- Sa herë që ndjehesh mirënjohës-e, je duke dhënë dashuri.
- Ji mirënjohës-e për gjithçka që ke pranuar në jetën tënde (e kaluara).
  Ji mirënjohës-e për gjithçka që po pranon në jetën tënde (e tashmja).
  Ji mirënjohës-e për atë që e dëshiron në jetën tënde, sikur ta kishe pranuar atë (e ardhmja).
- Mirënjohja jote do të shumëzojë gjithçka në jetën tënde.
- Mirënjohja është ura nga ndjenjat negative te përdorja e forcës së dashurisë!
- Për ta përdorur forcën e mirënjohjes, praktikoje atë. Kur çkado e mirë të ndodh në ditën tënde, jip falënderim. Nuk ka rëndësi se sa e vogël është, thuaj faleminderit.
- Sa më shumë që ndjen mirënjohje, aq më shumë dashuri jep; dhe sa më shumë dashuri që jep, aq më shumë pranon.
- Çdo sekondë kur je i-e lirë nga punët është shans të jesh mirënjohës-e dhe t'i shumëzosh gjërat që i do.

ÇELËSI I LOJËS

- Kur luan ti ndjehesh mirë - dhe rrethana vërtet të mira vijnë në jetën tënde. Serioziteti sjell rrethana serioze.
- Jeta është bërë të jetë argëtim!
- Ligji i tërheqjes nuk e di se a je duke imagjinuar dhe luajtur, prandaj çkado që jep në imagjinatë dhe lojë do të bëhet reale!
- Çkadoqoftë ajo që e dëshiron, përdore imagjinatën tënde, përdore secilën ndihmesë që mund ta gjesh, krijo lojëra, dhe luaj.
- Vepro sikur ta kesh tani! Çkado që e imagjinon me ndjenjë, je duke ia dhënë ligjit të tërheqjes, dhe patjetër do ta pranosh.
- Nëse përjeton vonesë në pranimin e asaj që e dëshiron, kjo ndodh vetëm për shkak të kohës që të duhet të arrish në frekuencën e njëjtë ndjenjore sikur dëshira jote.
- Kur je i-e ngazëllyer për çkadoqoftë dhe ndihesh mahnitshëm, shfrytëzoje atë energji dhe imagjinoje ëndrrën tënde.

FORCA DHE PARATË

- Është forca tërheqëse e dashurisë ajo që i lëviz tërë paratë në botë, dhe kushdo që është duke dhënë dashuri duke u ndjerë mirë është magnet për para.
- Mund të tregosh se si ndihesh në lidhje me paratë, sepse nëse nuk i ke të gjitha që të nevojiten, atëherë nuk ndihesh mirë në lidhje me paratë.
- Dashuria është forca tërheqëse që i sjell paratë, dhe dashuria është po ashtu edhe forca që i bën paratë të ngjiten!
- Kur i paguan faturat, gjeje një mënyrë, cilëndo mënyrë, për ta bërë veten të ndihesh mirë. Imagjino se faturat tua janë çeqe që po i pranon. Apo përdore mirënjohjen dhe jepi falënderime kompanisë që ta ka dërguar faturën.
- Kur vijnë te duart e tua ca para, pavarësisht sa pak janë, ji mirënjohës-e! Kujtoje, mirënjohja është shumëfishuesi i madh.
- Ndjej dashuri kur paguan për çkadoqoftë në vend se të ndjehesh keq se ke më pak para. Dallimi ndërmjet këtyre dyjave është dallimi ndërmjet të pasurit para me bollëk, dhe mundimeve me para për pjesën e mbetur të jetës tënde.
- Përdori paratë fizike si sinjal për të kujtuar të ndihesh mirë për bollëkun e parave. Imagjinoje fytyrën e secilës monedhë si anë pozitive, që përfaqëson bollëk të parave. Secilën herë që jep para, me paramendim ktheje monedhën ashtu që fytyra është e kthyer kah ti.
- Nëse ndihesh vërtet mirë për suksesin, pavarësisht suksesi i kujt është, ti ia ngjet suksesin vetes!
- Jip në vlerë të barabartë me paratë që i pranon përmes profiteve apo rrogës tënde. Nëse jep më shumë vlerë se sa paratë që i pranon, biznesi dhe karriera jote do të ngriten.
- Paratë janë vetëm vegël për ty për t'i përjetuar gjërat që i do në jetë. Forca tërheqëse e dashurisë ka mënyra të pakufizuara për ty për të pranuar çka dëshiron ti, dhe vetëm njëra nga ato mënyra i përfshin paratë.
- Imagjinoje të jesh me atë që e do, bërjen e asaj që e do, dhe të pasurit e gjërave që i do, sepse do të ndjesh larg më shumë dashuri se sa do të ndjesh kur mendon vetëm për paratë.
- Bukuria e jetës është se kur e vë dashurinë të parën, të gjitha paratë që të nevojiten për ta jetuar një jetë të plotë vijnë te ti.

FORCA DHE MARRËDHËNIET

- Me secilin person individual me të cilin bie në kontakt, ose je duke dhënë dashuri ose s'je duke dhënë. Dhe bazuar në çka jep, atë e pranon.
- Jepu dashuri të tjerëve përmes mirësisë, inkurajimit, përkrahjes, mirënjohjes, apo cilësdo ndjenjë të mirë, dhe të kthehet e shumëfishuar në secilën sferë të jetës tënde.
- Kërkoji gjërat që i do në një marrëdhënie më shumë se sa që i vëren gjërat negative dhe do të duket sikur i ka ndodhur diçka e çuditshme personit tjetër.
- Tentimi ta ndryshosh një person tjetër, të menduarit se e di se çka është më së miri për një person tjetër, të menduarit se e ke mirë dhe një person tjetër e ka gabim nuk është dhënie e dashurisë!
- Kritikimi, fajësimi, ankimi, bezdisja, apo gjetja e gabimeve te një person tjetër nuk është dhënie e dashurisë!
- Duhet të jesh i-e lumtur për të pranuar versione të lumtura të njerëzve tjerë!
- Forca e dashurisë të njofton me një koleksion të tërë të Trajnerëve Emocionalë Personalë, të maskuar si njerëz të përditshëm, por të gjithë ata janë duke të trajnuar që ta zgjedhësh dashurinë!
- Mund të ngjitësh te ti gjithçka që do dhe dëshiron duke i kërkuar gjërat që i do te njerëzit tjerë, dhe duke iu thënë 'po' atyre cilësive me tërë zemrën tënde!
- Nuk mund të flasësh për apo të dëgjosh negativitet dhe të kesh ndjenja të mira!
- Jeta ta paraqet secilin person dhe rrethanë ashtu që të mund të zgjedhësh se çka do dhe çka nuk do. Kur reagon ndaj diçkaje çkadoqoftë, ti po reagon me ndjenjat e tua, dhe ndërsa e bën këtë, je duke e zgjedhur atë!
- Nuk mund ta ndryshosh një situatë negative me ndjenja të këqija. Nëse vazhdon të reagosh negativisht, ndjenjat e tua të këqija do ta zmadhojnë dhe shumëfishojnë negativitetin.
- Nëse je duke u ndjerë në mënyrë fantastike, forca e fushës tënde magnetike e krijon një mburojë të cilën asnjë negativitet nuk mund ta depërtojë.
- Ndryshimi i mënyrës se si ndjehesh është i lehtë në krahasim me vrapimin përreth duke u munduar t'i ndryshosh rrethanat e botës së jashtme. Ndryshoji ndjenjat e tua dhe rrethanat e jashtme do të ndryshojnë!
- Sa më shumë që jep dashuri dhe ndihesh mirë, aq më magnetike bëhet fusha jote dhe aq më shumë zgjerohet, duke tërhequr gjithçka dhe çdokë që e do te ti!

FORCA DHE SHËNDETI

- Atë që ia jep vazhdimisht trupit tënd me besimet e tua apo ndjenjat e forta, atë e pranon në trupin tënd. Secila ndjenjë që e ke e njom secilën qelizë dhe secilin organ në tërë trupin tënd.
- Ti je sunduesi i - sunduesja e - një mbretërie, dhe qelizat e tua janë subjektet më besnike që të shërbejnë pa diskutim, kështu që çkado që mendon dhe ndjen bëhet ligj i mbretërisë tënde - ligji brenda trupit tënd.
- Kur jep mendime dhe ndjenja negative të asaj që nuk e dëshiron, forca e shëndetit të qelizave tua zvogëlohet! Kur ndjen dashuri për çkadoqoftë - për një ditë me diell, shtëpi të re, mik, apo ngritje në pozitë - trupi yt e pranon forcën e plotë të shëndetit.
- Mirënjohja është shumëfishuesi i madh, prandaj thuaj faleminderit për shëndetin tënd në secilën ditë.
- Thuaj faleminderit me tërë zemrën tënde për atë që të pëlqen te trupi yt, dhe injoroji gjërat që nuk të pëlqejnë.
- Për ta parë shëndetin tënd duke u përmirësuar, jepi dashuri shëndetit më shumë se pesëdhjetë për qind të kohës. Pika kthyese nga sëmundja në shëndet është vetëm 51 për qind.
- Nëse je duke u përballur me sëmundje, bëje më të mirën që mundesh të mos e zotërosh atë me mendimet dhe fjalët e tua. Në vend të kësaj, jepi dashuri shëndetit, zotëroje shëndetin, dhe bëje tëndin.
- Jip dashuri për peshën e përsosur, trupin e përsosur, shëndetin e përsosur të një organi, dhe imagjinoje se e ke, dhe ji tërësisht mirënjohës-e për gjithçka që ke!
- Nëse beson se trupi yt do të prishet me moshë, ti je duke e dhënë atë besim, dhe ligji i tërheqjes duhet të t'i kthejë ato rrethana.
- Ndjehu i ri - e re - dhe ndale të ndjerit e moshës tënde.
- Trupi yt do të ndryshohet në çkado që dëshiron ti, përmes ndjenjave tua të dashurisë dhe mirënjohjes.

FORCA DHE TI

- Gjithçka ka frekuencë - çdo gjë! Dhe çkado që je duke ndjerë është duke sjellë gjithçka në jetën tënde që është në frekuencë të ngjashme me ty.
- Jeta po të përgjigjet. Jeta është duke komunikuar me ty. Çdo gjë që e sheh - çdo shenjë, ngjyrë, person, objekt - gjithçka që dëgjon, çdo rrethanë dhe ngjarje, janë në frekuencën tënde.
- Kur je duke u ndjerë i-e lumtur, dhe vazhdon të ndjehesh i-e lumtur, atëherë vetëm njerëz, rrethana, dhe ngjarje të lumtura mund të vijnë në jetën tënde.
- Nuk ka aksidente apo koincidenca në jetë - gjithçka është sinkronicitet - sepse gjithçka ka frekuencë. Është thjesht fizika e jetës dhe universi në veprim.
- Mendo për diçka që e do, dhe bëje simbol tëndin të forcës së dashurisë. Sa herë që e sheh simbolin tënd apo e dëgjon atë, do ta dish se forca e dashurisë është me ty.
- Vëre forcën e dashurisë përpara teje në gjithçka që e bën. Imagjinoje secilën gjë në ditën tënde të shkojë mirë, dhe ndjeje dashurinë brenda teje sa më shumë që mundesh, para se të fillosh t'i bësh gjërat.
- Bëj pyetje secilën ditë. Kur e bën një pyetje, ti po e jep një pyetje, dhe patjetër duhet ta pranosh përgjigjen!
- Shfrytëzoje forcën e dashurisë për të të ndihmuar me çkadoqoftë në jetën tënde. Forca e dashurisë do të jetë ndihmësi yt personal, menaxheri yt i parave, trajnuesi yt personal i shëndetit, dhe këshilltari yt për marrëdhënie.
- Nëse mendja jote konsumohet me tepër detale, detalet do të të hutojnë dhe rrëzojnë. Thjeshtoje jetën tënde, dhe mos iu jep tepër rëndësi gjërave të vogla. Çfarë dallimi bën kjo?
- Forca e dashurisë nuk ka të kundërt. Nuk ka fuqi tjetër në jetë pos dashurisë. Të gjitha gjërat negative që i sheh në botë janë gjithmonë, gjithmonë mungesë e dashurisë.

FORCA DHE JETA

- Ti ke ekzistuar gjithmonë dhe do të ekzistosh gjithmonë sepse je pjesë e krijimit.
- Ti, secili person që e njeh, dhe secili person që ka jetuar ndonjëherë nuk keni fund!
- Ta gjesh parajsën në Tokë është ta jetosh jetën tënde në frekuencën e njëjtë si qenia jote - dashuri dhe gëzim i pastër.
- Gëzimi më i madh në jetë është dhënia, sepse nëse nuk jep, gjithmonë do të jesh duke u munduar të mbijetosh.
- Dashuria jote, gëzimi yt, pozitiviteti yt, ngazëllimi yt, mirënjohja jote, dhe pasioni yt janë gjërat e vërteta dhe të përhershme në jetë. Tërë pasuria në botë nuk mund as t'i vijë afër dhuratës më të paçmueshme në tërë krijimin - dashurisë brenda teje!
- Jepe dashurinë tënde sepse është magneti për të tërë pasurinë e jetës.
- Ndërsa je këtu, secilën herë që e zgjedh pozitiven, secilën herë që zgjedh të ndjehesh mirë, je duke e dhënë dashurinë tënde, dhe me të e ndriçon botën.

Të sjelltë Forca dashuri dhe gëzim

gjatë tërë ekzistencës tënde!

Ky është synimi im për ty,

dhe për botën.

PUBLIKIME TJERA

Të gjitha publikimet |:(|:) mund t'i shkarkoni falas nga web-faqet:

http://sites.google.com/site/kalabuli/jetes%C3%AB

http://sa-kra.ch/

http://www.syri3.com/

Faqja në Facebook: |:(|:) Publikimet RB

http://sites.google.com/site/kalabuli/

Po ashtu, ato mund t'i shkarkoni direkt nga linqet e mëposhtme.

TË LEHTA

- Magjia e të menduarit në përmasa të mëdha nga David Schwartz është program i plotë trajnues për vetë-zhvillim. Secili program trajnues duhet t'i bëjë tri gjëra. Duhet ta ofrojë përmbajtjen, çka-të-bëhet. E dyta, duhet ta ofrojë një metodë, si-të-bëhet. Dhe e treta, duhet ta kalojë testin acidor; d.m.th. të merren rezultatet.
- Pa stres është koleksion i afirmimeve pozitive nga Louise Hay, i miratuar dhe i rekomanduar nga Daut Demaku. Stresi është bërë fjalë e përditshme dhe ne e përdorim si arsyetim për mosmarrje të përgjegjësisë për ndjenjat tona. Nëse mund ta zëvendësojmë fjalën stres me fjalën frikë atëherë mund të fillojmë ta eliminojmë nevojën për frikë në jetën tonë.
- Jeni lindur të pasur ta jep sistemin e plotë për përdorjen e potencialit që e ke mbyllur brenda vetes për të arritur mirëqenie financiare, emocionale, fizike dhe shpirtërore.
- Leksiku me afirmime pozitive është lojë e përpiluar dhe e programuar nga Artan Bunjaku. Programi e zgjedh një afirmim pozitiv dhe ju duhet t'ia qëlloni se cili është ai duke e zbuluar shkronjë për shkronjë. Kjo është një mënyrë e shkëlqyeshme e metabolizimit të të vërtetave pozitive përmes lojës.
- Zhvillimi i katër inteligjencave/zotësive është udhërrëfyes praktik për zhvillimin e të katër aspekteve njerëzore që të bëjnë njeri të plotë. Nxjerrë nga Zakoni i 8të i Stephen Covey-t, ky është publikim interesant për çdokë.
- Disciplina e BL (Bëj Lehtë) është një shkrim atraktiv për mënyrën e lehtë të bërjes së gjërave dhe për përdorimin e energjisë e përpjekjeve optimale për realizim.
- Lumturia dhe Pasuria mund t'i ndihmojë cilitdo, që po lufton me paratë, për ta gjetë një rrugë për jetë më të mirë financiare.
- Dashuria në distancë flet për sfidat e mbajtjes së lidhjes romantike në distancë.
- Stresi në punë përmban këshilla për menaxhimin e stresit në ambientin e punës
- Meditimi i lehtë është një artikull hyrës për meditimin që e përshkruan një teknikë krejt të thjeshtë.

TË MESME

- Ndieje mirënjohjen. Secili përjetim i mundur është këtu. Dashuria. Shëndeti. Suksesi. Urtia. Gjithçka. E tëra është brenda Oqeanit dhe në dispozicion kur ti hapesh dhe e lejon atë brenda. Jeta është absolutisht e mirësjellshme në lidhje me këtë dhe nuk do të imponohet kurrë. Jeta nuk do të të detyrojë kurrë të kesh më shumë lumturi se sa je duke dashur ta shijosh.
- Shtatë Zakonet e Njerëzve me Efektivitet të Lartë është pasqyrë e shkëlqyeshme e praktikave individuale dhe ndërpersonale që do ta bëjnë çdo individ dëgjues, nxënës, partner, dhe lider më efektiv. Ai i sugjeron disa korniza të shkëlqyeshme për ta avancuar performansën personale.
- Zakoni i 8të - Depërtimi në nivelet më të larta të motivimit njerëzor kërkon model të ri mendor, grup të ri të shkathtësive - zakon të ri. Zakoni i 8të i Stephen Covey-t është hartë për të të ndihmuar ta gjesh përmbushjen dhe ngazëllimin tënd ditor.
- Esenca e dijes nga Sekreti e përmban thelbin e librit "Sekreti" të Rhonda Byrne: Ligji i Tërheqjes në praktikë.
- Mirënjohja dhe Falënderimi është një doracak praktik për energjinë pozitive që e ka në qendër shprehjen e mirënjohjes për të mirat që i kemi.
- 11 ligjet e harruara është një zgjerim i konceptit të Ligjit të Tërheqjes; ligje të mendjes të analizuara e të formuluara bukur nga Bob Proctor.
- Ashtu si mendon njeriu është ese letrare e James Allen e vitit 1902, një hyrje e bukur në shkencën e të menduarit dhe të ndjenjave. "Shpirti e tërheq atë të cilën e strehon fshehtas; atë që e do, dhe po ashtu edhe atë të cilës i frikësohet; ai e arrin lartësinë e aspiratave të tij më të dashura; ai bie në nivelin e dëshirave të tij të papastra, dhe rrethanat janë mjetet me të cilat shpirti e pranon të veten."
- E vetmja frikë është frika vetë është fjalimi i presidentit amerikan në kohën e depresionit të thellë. Ka shumë paralele ndërmjet gjendjes së popullit amerikan më 1932 dhe popullit tonë tash.

TË AVANSUARA

- Shtatë ligjet shpirtërore të suksesit, i miratuar dhe i rekomanduar nga Daut Demaku, e shpjegon idenë se suksesi personal nuk është rezultat i punës së mundimshme, planeve precize apo ambicies së furishme, por i kuptimit të natyrës sonë themelore si qenie njerëzore dhe si t'i ndjekim ligjet e natyrës. Kur i kuptojmë dhe i aplikojmë këto ligje në jetën tonë, çdo gjë që dëshirojmë mund të krijohet, "sepse ligjet e njëjta që i përdor natyra për ta krijuar një pyll, një yll, apo një trup njeriu mund ta shkaktojnë edhe përmbushjen e dëshirave tona më të thella".

- Mbështetja në vetveten e përmban deklarimin më të plotë të njërës nga temat kryesore të Emersonit, nevojën për secilin individ që ta lërë konformitetin dhe konsistencën false, dhe t'i përcjellë instinktet dhe idetë e veta.

- Hapat A deri në Z për krijimin e begatisë është material i shkëlqyeshëm për studim ditor apo dëgjim. Është thelbi i koncepteve të Dipak Çoprës që i shpjegon me fjalë të thjeshta ligjet shpirtërore të suksesit. "Creating Affluence" (Krijimi i begatisë) është distiluar në "The seven spiritual laws of success" (Shtatë ligjet shpirtërore të suksesit).